



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"  
REKTORATI

## NJOFTIM

**PËR PROCEDURAT E PRANIMIT DHE TË REGJISTRIMIT TË  
KANDIDATËVE QË APLIKOJNË PËR TRANSFERIM TË STUDIMEVE DHE  
PËR PROGRAM TË DYTË STUDIMI NË PROGRAMET E CIKLIT TË PARË,  
NË PROGRAMET E INTEGRUARA TË CIKLIT TË DYTË DHE PROGRAMET  
E STUDIMIT ME KARAKTER PROFEËSIONAL  
PËR VITIN AKADEMIK 2018-2019**

**NË  
UNIVERSITETIN "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR**

Ju njoftojmë se aplikimet për procedurat e pranimit dhe të regjistrimit të kandidatëve që aplikojnë për transferim të studimeve dhe për program të dytë studimi në programet e ciklit të parë, në programet e integruara të ciklit të dytë dhe programet e studimit me karakter profesional bëhen pranë sekretarive të njësive kryesore në periudhën ,

**3 Shtator deri në 14 Shtator 2018**

**Kandidatët që aplikojnë për transferim studimesh paraqiten personalisht ose nëpërmjet një personi të autorizuar prej tij pranë sekretarisë mësimore dhe dorëzon dokumentacionin e mëposhtëm:**

- a.** Kërkesa drejtuar UGJ-së për programin e studimit, në të cilin do të transferojë studimet (ose formulari i aplikimit sipas shtojcës nr. 7)
- b.** Plani i plotë i programit të studimit përfshirë dhe syllabuset përkatëse;

- c. Vërtetim i listës së notave dhe krediteve të fituara për çdo lëndë dhe detyrimin e shlyer, i cili do të shërbejë për ekuivalentim të notave të lëndëve të programit të studimit të ndjekur. Studentët që transferojnë studimet e tyre nga një institucion i huaj i arsimit të lartë, planin e plotë të programit të studimit përfshirë dhe syllabuset përkatëse dhe listën e notave dhe krediteve të fituara për çdo lëndë dhe detyrim të shlyer, duhet t'i dorëzojë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të njëjshuar me origjinalin.
- d. Kandidati që ka përfunduar shkollën e mesme në Republikën e Shqipërisë përpara vitit 2011, të dorëzojë fotokopje të noterizuar të dëftesës së pjekurisë të shkollës së mesme. Në mungesë të diplomës së Maturës Shtetërore apo Dëftesës së Pjekurisë së shkollës së mesme duhet të paraqesë dublikatë të dëftesës së pjekurisë të lëshuar nga DAR/ZA ose listën e notave të lëshuar nga Arkivi i Shtetit;
- e. Fotokopje e dokumentit të identifikimit (karta e identitetit, letërnjoftim ose pasaportë)
- f. Dy fotografi
- g. Mandat pagesa e tarifës së aplikimit në UGJ.

**Kandidati që aplikon për program të dytë studimi paraqiten personalisht ose nëpërmjet një personi të autorizuar prej tij pranë sekretarisë mësimore dhe dorëzon dokumentacionin e mëposhtëm:**

- a. Kërkesa drejtuar UGJ-së për programin e studimit, në të cilin aplikon për program të dytë studimi (formulari i aplikimit sipas shtojcës 7)
- b. Kopje e noterizuar e diplomës universitare të kryer më parë, të shoqëruar me suplementin e diplomës.
- c. Vërtetim të listës së notave dhe kreditet e fituara për çdo lëndë dhe detyrim të shlyer, i cili do të shërbejë për ekuivalentimin e notave të lëndëve të programit të studimit të ndjekur (nëse kërkohet njohja e provimeve të shlyera dhe/ose e krediteve përkatëse).
- d. Kandidati që ka përfunduar shkollën e mesme në Republikën e Shqipërisë përpara vitit 2011, të dorëzojë fotokopje të noterizuar të dëftesës së pjekurisë të shkollës së mesme. Në mungesë të diplomës së Maturës Shtetërore apo dëftesës së pjekurisë së shkollës së mesme duhet të paraqesë dublikatë të dëftesës së pjekurisë të lëshuar nga drejtoria e shkollës së mesme dhe të vërtetuar në DAR/ZA përkatëse, ose listën e notave të shkollës së mesme të lëshuar nga Arkivi i Shteti;
- e. Fotokopje e dokumentit të identifikimit (kartë identiteti, letërnjoftimi ose pasaportë)
- f. Dy fotografi
- g. Mandat pagesa e tarifës së aplikimit në UGJ.

Për çdo informacion shtesë mund të vizitoni faqen online të univerësitetit [www.uogj.edu.al](http://www.uogj.edu.al) dhe mund të kontaktoni në numrin e kontaktit 06840300043.

## REKTORATI

### I

## UNIVERSITETIT "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR